

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË " mimmo Albania " SH.P.K.**

Sot, me datë 05/02/2024

- **Z. Burim Ibishi**, i biri i Qemal-it, Shtetas Kosovar, banues Rruga rr: Voskopoja nr: 35 Prishtine, Kosove, mbajtëse i pasaportes me nr P01401007 madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.;
- **Z. Labeat Mustafa**, i biri i Mehmet-it, Shtetas Kosovar, banues Rruga UÇK, nr 22 Prishtine, Kosove, mbajtëse i pasaportes me nr NR P00902283 madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**mimmo Albania**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**mimmo Albania**" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në Tirane, **Rruga Kavajes, Kompleksi Arlis SQ21, Faza 2, shkalla 2 dyqani nr 3, Tirane, Shqiperi**.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përvèç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- *Tregtim produktesh përfëmijë, karroca belesh dhe aksesorë të ndryshëm, Import-Eksport.*


Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 200.000 Lek dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:



- **Z. Burim Ibishi** zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100,000 Lek dhe 100,000 Lek të kapitalit themeltar.
- **Z. Labeat Mustafa** zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100,000 Lek dhe 100,000 Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z.Burim Ibishi, shtetas Kosovar, lindur më 01/07/1976 në Preshevë, Kosove, mbajtes i Pashaportes Nr. P01401007 madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.**


NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Burim Ibishi



Z. Labeat Mustafa

